



**Datë:** 13.03.2026  
**Numër Protokolli:** 1317/2026

**A.nr. 41/2026**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me A.nr.41/2026, e datës 14.01.2026, të parashtruar nga ankuesja D.Sh nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komunës së Shtimes, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.41/2026, e datës 14.01.2026, e parashtruar nga ankuesja D.Sh.
- II. Anulohet** në tersi procedura e pranimit e shpallur sipas konkursit me Nr. Reference: RN00018981, për Grupin e Shkencave Natyrore, për pozitën “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, i shpallur me datë 11.11.2025, nga Komuna e Shtimes, si dhe çdo veprim procedural që rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. Obligohet** Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr veprimet e nevojshme administrative si në pikën II të dispozitivit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Ar sy e t i m

Kandidatja për praninë në shërbimin civil, D.Sh (në tekstin e mëtejshëm referuar: ankuesja), më datë 14.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më numër protokolli:90/2026, kundër procedurës së rekrutimit lidhur me konkursin me Nr. reference RN00018981 për grupin shkencave natyrore, pozita “Inspektor i Tokës Bujqësore” të shpallur nga Komuna e Shtimes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 20.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Shtimes, ndërsa kjo e fundit më datë 22.01.2026 ka përcjellë përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit, me datë 10.02.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:742/2026, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjën A.nr.41/2026 të datës 14.01.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 90/2026, të datës 14.01.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për regjistrimin e ankesës, të datës 14.01.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.01.2026; Vendim i datës 16.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses D.SH; Përgjigjen në ankesë të datës 22.01.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00018981, të datës 11.11.2025; Kërkesë për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: Inspektor i Bujqësisë e datës 20.03.2025; Formulari i përshkrimit të punës; Vendim për formimin e komisionit të pranimit, me numër Nr.02-1420, i datës 16.02.2025; Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit; Aplikacioni me datë aplikimi 07.12.2025, të ankueses D.SH, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 18.11.2025 të kandidatit L.J, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve të datës 24.12.2025.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Shtimes, më datë 11.11.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00018981, për Grupin e Shkencave Natyrore, pozita “Inspektor i Tokës Bujqësore”, klasa profesional 1, afati i aplikimit nga data 12.11.2025 deri më datë 11.12.2025, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Sipas Vendimit me Nr. 02/1-155 të datës 16.12.2025, të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes, ankueses i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk plotëson kriterin e arsimit, të konkursit sepse drejtimi Ndërtimtari nuk është përcaktuar si kriter i konkursit, kurse Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtimes pas përfundimit të procedurës më datë 24.12.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me kandidatin fitues L. J. me gjithsej 85.2 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit, për shkak të mos përfshirjes në listën e ngushtë, pretendon se vendimi për refuzimin e aplikacionit është i paligjshëm me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj si dhe të verifikohet dokumentacioni i dorëzuar përfshirë diplomën universitare.

Para se të lëshohet në shqyrtimin përkatës të pretendimeve ankimore të ankueses, me qëllim të analizimit të lëndës përkatëse nëse me rastin e shpalljes së konkursit Komuna e Shtimes, ka zbatuar parimet e ligjshmërisë në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit fillimisht analizoi aktin e shpalljes së konkursit, dhe konstatoi se konkursi me Nr. Reference: RN00018981, për pozitën “*Inspektor i Tokës Bujqësore*” është shpallur në kuadër të Grupit të Shkencave Natyrore, ndërsa sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas Vendimit me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, pozita *Inspektor i Tokës Bujqësor*, është paraparë në Kodin SHC-0089, në klasën profesional 1 dhe Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës. Rrjedhimisht Kolegji, me rastin e vendosjes ka marr parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil e cila në nenin 31 paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar: “1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 2. Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë”, andaj sipas këtij përcaktimi si dhe referuar Shtojcës Nr. 2 të kësaj rregulloreje Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës është paraparë sipas numrit rendor 30, dhe ku është paraparë fusha e arsimit *Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veterinari*, identike sikurse në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Përkitazi me këtë, Kolegji i Këshillit konstaton se konkursi me Nr.Reference: RN00018981, për pozitën “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, është shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ngase është shpallur në Grupin e Shkencave Natyrore e jo në grupin e përcaktuar për këtë pozitë pra në Grupin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, e për rrjedhojë shpallja e konkursit në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, e bënë këtë proces të kundërligjshëm, e që sipas Kolegjit të Këshillit kjo procedurë e pranimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se: “1. Pranimi në detyrë i **nëpunëses/it civil**, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”, dhe si e tillë përveç aktit të shpalljes së konkursit edhe çdo veprim tjetër procedural i ndërmarr në këtë procedurë është juridikisht i pavlefshëm dhe nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konsiderohet procedurë e paligjshme.

Prandaj nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit thekson faktin se nuk u lëshua në shqyrtimin e mëtejme të pretendimeve ankimore të palës ankuese, pasi që është konstatuar se shpallja e procedurës së rekrutimit qysh në inicim ka cenuar parimet e pranimit dhe ligjshmërisë në Shërbimin Civil, e për rrjedhojë ky fakt përbën argument ligjor që ankesa e ankueses të aprovohet vetëm mbi bazën e konstatimit të dhënë si më lartë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia për Burime Njerëzore në Komunën e Shtimes, është e obliguar që në pikëpamje të dispozitivit dhe arsytimit të këtij vendimi të ndërmarr veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, thënë si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda:A.nr.41/2026, datë 13/03/2026**

**Avdyl BEKTESHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses D.Sh;
- Komunës së Shtimes (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSCK-së.